

VENDIM
Nr. 3, datë 20.11.2012

PËR PËRCAKTIMIN E SHTETEVE, ME NIVEL TË MJAFTUESHËM TË MBROJTJES SË TË DHËNAVE PERSONALE

(ndryshuar me vendimin nr. 7, datë 9.2.2016)

(i përditësuar)

Mbështetur në pikën 1 të nenit 8 të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar dhe vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr. 211, datë 11.9.2008 “Për zgjedhjen e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, nr. 225, datë 13.11.2008 “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së *Komisioneri për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale*”,

VENDOSA:

1. Shtetet që kanë nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale, janë:
 - a) shtetet anëtare të Bashkimit Europian;
 - b) shtetet anëtare të Zonës Ekonomike Europiane;
 - c) *palët e Konventës nr. 108 të Këshillit të Evropës, “Për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale”, si dhe të protokollit shtesë të saj të vitit 1981, të cilat kanë miratuar një ligj të posaçëm dhe kanë ngritur një autoritet mbikëqyrës që ushtron funksion në pavarësi të plotë, duke siguruar mekanizmat e duhur ligjorë, përfshirë trajtimin e ankesave, hetimin dhe garantimin e transparencës së përpunimit të të dhënave personale;*
 - ç) shtetet ku mund të transferohen të dhënat personale, sipas një vendimi të Komisionit të Bashkimit Europian.
 2. Shtetet, me nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale evidentohen në aneksin nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi.
 3. *Komisioneri për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale* është autoriteti përgjegjës për përditësimin e listës së shteteve me nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale, të parashikuar në aneksin nr. 1. Lista e përditësuar publikohet në faqen zyrtare të Autoritetit të Komisionerit në internet.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KOMISIONERE
Flora Çabej (Pogaçe)